



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

RAPORT MONITORUES

Monitorimi i lëndëve penale: “Vjedhje e pyllit” në Gjykatat Themelore të Kosovës



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET – ÇOHU

RAPORT MONITORUES

*Monitorimi i lëndëve penale: “Vjedhje e pyllit” në
Gjykatat Themelore të Kosovë*

Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizatës ÇOHU! dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.



PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| 1. METODOLOGJIA | 3 |
| 2. HYRJA..... | 4 |
| 3. RAPORTI I LËNDËVE NË GJYKATAT E KOSOVËS PËR KAPITULLIN XXVIII- (Veprat Penale kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, Kodi Penal i Republikës së Kosovës)..... | 5 |
| 3.1 Pasqyra e të dhënave mbi lëndët e Kapitullit XXVIII për vitet 2013 dhe 2014..... | 5 |
| 3.2 Sfidat e gjykatave në trajtimin e lëndëve për vjedhje pylli..... | 8 |
| 4. PARASHKRIMI I LËNDËVE PENALE PËR VJEDHJE PYLLI | 11 |
| 4.1 Pasqyra e të dhënave të parashkrimit të lëndëve për vjedhje pylli për vitin 2013 dhe vitin 2014..... | 11 |
| 4.2 Indikatorët me ndikim në parashkrimin e lëndëve për vjedhje pylli | 19 |
| 5. Masat ndëshkimore për vjedhje pylli..... | 21 |
| 5.1 Pasqyra e të dhënave mbi lëndët e zgjidhura me aktgjykim | 21 |
| 6. Përfundimi..... | 25 |



1. METODOLOGJIA

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet Çohu! ka realizuar një raport monitorues, ku objekt monitorimi ishin lëndët të cilat i përkasin Kapitullit XXVIII-Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), në gjykatat themelore dhe degët e tyre përkatëse në mbarë Kosovën.

Raporti mbulon gjendjen e lëndëve në gjykatat themelore dhe degët për vitin 2013¹ dhe vitin 2014, për të vazhduar me analizimin e të dhënave për vitin 2015 në pjesën e dytë, raport ky i cili do të mbulojë monitorimin për periudhën e vitit 2015 si dhe do të sjellë analizën mbi funksionimin e zinxhirit institucional përkatës.

Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar tri nene të Kapitullit XXVIII të KPRK-së, përkatësisht Nenin 347/276 Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, Neni 357/ 284 shkatërrimi i pyjeve dhe Neni 358/285 Vjedhja e pyllit.

Ky raport monitorues u realizua me metodologji të kombinuar dhe përfshin dy faza të monitorimit.

Në fazën e parë është bërë mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi numrin e lëndëve të këtij kapitulli në mbarë gjykatat dhe degët e tyre përkatëse.

Të dhënat mbi raportin e lëndëve dhe punën e gjykatave për vitet në fjalë janë siguruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

Pas analizës së të dhënave vjetore për vitin 2013 dhe vitin 2014 të Kapitullit XVIII, si fazë fillestare e monitorimit, është vendosur që në këtë raport të përfshihen vetëm lëndët në Nenin 358/285 Vjedhja e pyllit. Ky vendim u mor pasi 97.29% e të gjitha lëndëve të komplet Kapitullit XXVIII rezultuan t'i takonin këtij neni, pra vjedhjes së pyjeve.

Faza e dytë e monitorimit përfshin intervistat e thella në disa nga gjykatat dhe degët e tyre, si dhe analizimin e infrastrukturës ligjore dhe raporteve relevante.

Për realizimin e këtij hulumtimi si mostër u morën gjykatat dhe degët ku konsiderohet që dëmtimi i ambientit si dhe numri i lëndëve penale për këtë nen është më i madh.

Të gjeturat e këtij raporti duhet theksuar se janë një burimore dhe burojnë nga të dhënat dhe informatat e siguruar nga gjykatat themelore dhe degët.

Intervistat u realizuan në Gjykatën Themelore Prishtinë, Degën Podujevë, Gjykatën Themelore të Pejës, Degën e Deçanit, të Istogut dhe Gjykatën Supreme të Kosovës.

¹ Sqarim: Të dhënat për vitin 2013 devijojnë për diku 7 lëndë si pasojë e kombinimit të të dhënave nga dy llojet e databazave, sipas nenit të Kodit të Përkohshëm Penal dhe sipas Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës.



2. HYRJA

Pyjet në Kosovë mbulojnë 481.000 hektarë, ose 45% të sipërfaqes së përgjithshme.² Prerja e pyjeve konsiderohet të jetë tepër e lartë. Nga të gjitha prerjet vjetore të pyjeve, 86% klasifikohen si prerje e peregjistruar. Kjo shifër sipas të gjitha standardeve është e lartë³

Kjo gjendje e rëndë e pyjeve nga prerjet ilegale pasqyrohet edhe me numrin e lëndëve për vjedhje pylli në gjykatat e Kosovës. Përveç numrit të lartë të lëndëve edhe parashkrimi i këtyre lëndëve është tepër i lartë. Vepra penale vjedhje e pyllit është vepra më e parashkruar ndër vite. Në raportin monitorues të realizuar nga Organizata Çohu! për komplet parashkrimin e lëndëve nga viti 2001 deri në vitin 2014 rezulton që vepra penale që është parashkruar më së shumti është vjedhja e pyllit neni 358/285 me gjithsej 1783 lëndë të parashkruara.

Qëllim i këtij monitorimi përveç adresimit të çështjes së mjedisit përmes trajtimit të këtyre lëndëve në gjykata, janë edhe sfidat që gjykatat themelore si dhe degët e tyre hasin në trajtimin e këtyre lëndëve.

Reformimi i sistemit gjyqësor në Kosovë i cili filloi me nxjerrjen e ligjit mbi gjykatat, ku pasoi edhe nxjerrja e Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës si dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (këto dy të fundit janë në fuqi nga 1 janari 2013), solli ndryshime për gjykatat e Kosovës përfshirë emërtimin dhe strukturën e tyre. Si pjesë e reformimit të sistemit gjyqësor ishte edhe rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjykatat dhe prokuroritë e vendit.

Ky aspekt i reformës krijoi infrastrukturën njerëzore të domosdoshme për fillim e menaxhimin më të mirë të lëndëve si dhe parandalimin e parashkrimit/vjetërsimit të lëndëve penale që është ndër problemet madhore në gjykatat e Kosovës. Përkundër reformës gjykatat e Kosovës ende ballafaqohen me probleme të mëdha.

Parashkrimi i lëndës penale lind kur kryesi i veprës penale nuk mund të zbulohet, ose mund të ndodhë që kryesi të dihet por organet e ndjekjes penale nuk mund ta gjejnë atë.

“Parashkrimi apo vjetërsimi është institut juridik i cili shpie në shuarjen e sanksioneve penale për shkak të kalimit të kohës së caktuar me ligj. Kur paraqitet parashkrimi, shteti humb të drejtën e zbatimit të sanksioneve penale ndaj kryesit të veprës penale”⁴.

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti vetëm gjatë vitit 2013 dhe 2014 shteti humbi të drejtën e zbatimit të sanksioneve penale për 1603 lëndë për vjedhje pylli.

²Inventarizimi Nacional i Pyjeve të Kosovës 2012, Norwegian Forestry Group në bashkëpunim me Agjencinë Pyjore të Kosovës, http://www.fiskos.org/wp-content/uploads/2014/11/INP_Permbledhje_Tetor_2014_Alb.pdf

³ Draft raport, Studimi i sektorit pyjor të Kosovës 2013, Konzorcium kornize i udhëhequr nga SIPU International AB, 2013, <http://kosovoforests.org/wp-content/uploads/2013/04/Final-draft-ALB-2013-05-271.pdf>

⁴ Po aty, faqe558.



3. RAPORTI I LËNDËVE NË GJYKATAT E KOSOVËS PËR KAPITULLIN

XXVIII- (Veprat Penale kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, Kodi Penal i Republikës së Kosovës)

Reformimi i sistemit gjyqësor në Kosovë i cili filloi me nxjerrjen e ligjit mbi gjykatat, ku pasoi edhe nxjerrja e Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës si dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, solli ndryshime për gjykatat e Kosovës përfshirë emërtimin dhe strukturën e tyre.

Të gjitha këto dokumente, materiale dhe procedurale në lëmin penale kanë hyrë në fuqi me 1 janar 2013. Si pjesë e reformës së sistemit gjyqësor ishte edhe rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjykatat dhe prokuroritë e vendit.⁵

Kjo rritje e numrit të gjyqtarëve mëtoi përmirësimin e performancës së gjykatave të cilat ishin të mbingarkuara me numër tejet të lartë të lëndëve, të grumbulluara ndër vite, e që shumë nga to funksionin me vetëm nga një gjyqtar përgjegjës për lëndët si penale po ashtu edhe ato civile.

Ky aspekt i reformës krijoi infrastrukturën njerëzore të domosdoshme për fillimin e menaxhimit më të mirë të lëndëve si dhe parandalimin e parashkrimit/vjetërsimit të lëndëve penale që është ndër problemet madhore në gjykatat e Kosovës.

3.1 Pasqyra e të dhënave mbi lëndët e Kapitullit XXVIII për vitet 2013 dhe 2014

Në vitin 2014 në të gjitha gjykatat e Kosovës (gjykatat themelore dhe degët përkatëse) numri total i lëndëve penale në punë⁶ të Kapitullit XXVIII –Veprat Penale kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, Kodi Penal i Republikës së Kosovës⁷, ishte 6794. Nga totali i këtyre lëndëve 6610 prej tyre i takojnë vetëm një neni, nenit 358/285 Vjedhja e pyllit. Pra, 97.29 % e lëndëve në këtë kapitull i takojnë veprës penale vjedhje e pyllit.

Numri total i lëndëve të parashkuara të këtij kapitulli ishte 607, ku nga ky total 604 lëndë ishin vjedhje e pyllit dhe vetëm 3 lëndë i përkisnin neneve tjera të këtij kapitulli.⁸

Këto të dhëna, respektivisht numri i madh i lëndëve në gjykata për këtë nen, pasqyrojnë në masë të madhe dëmtimin që iu bë pyjeve të Kosovës nga prerjet e pakontrolluara ilegale por, njëkohësisht numri i madh i parashkrimit të këtyre lëndëve vë në pah edhe pamundësinë e gjykatave për të shqyrtuar këto lëndë si mundësi e rregullimit ligjor të kësaj fushe. Tabela e mëposhtme po ashtu tregon se dëmtimet tjera eventuale të mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore paraqiten rrallëherë në gjykata.

⁵Parashkrimi i Ndjekjeve Penale dhe Ekzekutimeve Penale 2013, Organizata Çohu, faqe 6, http://cohu.org/repository/docs/Parashkrimi_final_2013_84095_304261.pdf


⁶ Lëndët në punë përfshijnë lëndët që janë trashëguar nga viti paraprak përfshirë lëndët që janë paraqitur gjatë vitit ekzistues. Totali i këtyre dyjave tregon se sa lëndë kanë qenë në punë në vitin ekzistues.

⁷Kodi Penal i Republikës së Kosovës


[http://www.gjykatasupreme-ks.org/repository/docs/Kodi_Penal_i_R.Kosoves_\(shqip\)_149582.pdf](http://www.gjykatasupreme-ks.org/repository/docs/Kodi_Penal_i_R.Kosoves_(shqip)_149582.pdf)

⁸ Në vazhdimin e përmbajtjes së raportit do të trajtohen vetëm lëndët e Nenit 358/285 Vjedhja e pyllit, Kapitulli XXVIII, Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Grafi 1: Raporti i lëndëve në Kapitullin XXVIII –Veprat Penale kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, për vitin 2014



Grafi 1.1: Raporti i lëndëve në Kapitullin XXVIII –Veprat Penale kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe Objekteve Kulturore, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, për vitin 2013




Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Përveç numrit të përgjithshëm tejet të lartë të lëndëve në këtë kategori, të grumbulluara ndër vite, edhe numri i lëndëve që paraqiten në bazë vjetore është mjaft i lartë. Vetëm në vitin 2014 në gjykatat themelore dhe degët e tyre në mbarë Kosovën janë paraqitur 1698 lëndë për vjedhje pylli, pra 25,68 % e totalit. Shifra e lëndëve të pranuar në punë për vitin 2013 po ashtu nuk dallon shumë nga viti pasues, me gjithsej 1603 lëndë të pranuar.

Sa i përket zgjidhjes së lëndëve brenda vitit në gjykatat e Kosovës në vitin 2014 janë zgjidhur 2559 lëndë apo 38,71% e totalit të lëndëve në punë, ndërsa në vitin 2013 u zgjidhën 2415 lëndë apo 37,71% e totalit të lëndëve në punë. Edhe pse këto shifra e tejkalojnë shifrën e lëndëve të paraqitura në bazë vjetore, numri i lëndëve që barten në vitin vijues është tejet i lartë, 4051 lëndë apo 61,28% e lëndëve për vjedhje pylli janë bartur nga viti 2014, ndërsa në vitin 2013 janë bartur 4082 lëndë apo 62,83% e lëndëve për vjedhje pylli. Duke marrë për bazë shifrat e numrit të lëndëve të bartura për vitet në vijim së bashku me numrin e lëndëve të pranuar brenda viteve mund të konsiderojmë që edhe në vitet në vijim gjykatat do të kenë numër të përafërt të lëndëve në punë për vjedhje pylli.

Nga krahasimi i lëndëve të bartura nga viti 2013, prej kur filloi edhe reforma me numër të shtuar të gjyqtarëve, dhe 2014 vërehet një rënie e vogël prej 1.55% të lëndëve të bartura për vitet pasuese.

Grafi 2: Menaxhimi vjetor i lëndëve për vjedhje pylli për vitet 2013 dhe 2014.




Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Sa i përket menaxhimit vjetor të lëndëve gjykatat dhe degët për vitin 2014 zgjidhën 2559 lëndë, ndërsa në vitin 2013 u zgjidhën 2415 lëndë.

Kjo shifër zbehet edhe më tej kur kemi parasysh që në këtë total të lëndëve të zgjidhura në bazë vjetore përfshihen edhe lëndët e parashkuara vjetore e që kapin shifrën 604 apo 23.60% e lëndëve të zgjidhura në vitin 2014 dhe 999 apo 40.46% në vitin 2013.

Grafi 3: Parashkrimi i lëndëve vjedhje e pyllit në raport me lëndët e zgjidhura në fund të viteve 2013 dhe 2014.



Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

3.2 Sfidat e gjykatave në trajtimin e lëndëve për vjedhje pylli

Përveç problemave të pasqyruara nga analiza e të dhënave statistikore monitorimi i gjykatave themelore dhe degëve për trajtimin e lëndëve për vjedhje pylli vë në pah një sërë problemesh dhe pengesash. Në tjetër element i rëndësishëm i hasur gjatë hulumtimit ishin edhe pengesat që vinin nga institucionet tjera me rol kyç në ekzekutimin e këtyre lëndëve, si policia apo edhe autoritetet e pyjeve që në rastin e lëndëve për vjedhje pylli janë të vetmit dëshmitarë.

Përkundër klasifikimit duhet përmendur që këto dy kategori problemesh (që do të trajtohen në vazhdim) vazhdimisht gërshetohen dhe të njëjtat përcjellin trajtimin e këtyre lëndëve nga një fazë në tjetrën apo nga një institucion në tjetrin, gjithnjë në dëm të zgjidhjes së rasteve për vjedhje të pyjeve.

Gjatë monitorimit janë identifikuar dy kategori të problemeve: *a) Probleme që buronin nga vetë sistemi gjyqësor dhe b) problemet që barteshin nga jashtë, institucionet tjera vartëse të ekzekutimit apo të rëndësisë tjetër.*

a) Problemet që burojnë nga vetë sistemi gjyqësor

- Numri i gjyqtarëve në raport me lëndët

Gjykatat themelore dhe degët në Kosovës, përkundër reformës dhe përmirësimit të infrastrukturës në njerëz, përkatësisht shtimit të numrit të gjyqtarëve, ende janë të mbingarkuara me lëndë dhe numri i gjyqtarëve që posedojnë është i pamjaftueshëm për trajtimin e numrit të madh të lëndëve.

Punën e gjykatave me numër të madh të lëndëve e vështirëson edhe më tej angazhimi i gjyqtarëve në trupat gjykuese përveç angazhimit me lëndët e ngarkuara për gjyqtar.

Për shembull, Gjykata Themelore e Prishtinës ka numër jashtëzakonisht të lartë të lëndëve në raport me numrin e gjyqtarëve.

Kjo Gjykatë ngarkohet edhe më tej sipas Ligjit për Gjykatat Nr 03/L- 199, Neni 11, pika 3,⁹ pasi që çështjet administrative dhe ekonomike janë kompetencë ekskluzive e kësaj gjykate, për mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Apo rasti i Degës në Podujevë ku përkundër shtimit të numrit të gjyqtarëve ende ka mbi një mijë lëndë për gjyqtar.

Përkundër kësaj ka edhe gjykata apo degë që deklarohen se kanë numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve në raport me lëndët në punë.

⁹Ligji për Gjykatat e Kosovës, Nr. 03/L-199, Neni 11, pika 3.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2700>



- Procedura e tej zgjatur për zëvendësimin e gjyqtarëve.

Një problem tjetër i hasur është edhe pamundësia e zëvendësimit të menjëhershëm të gjyqtarëve në rast zhvendosjeje, pensionimi apo në rast të vdekjes.

Kryetarët e Gjykatave si dhe gjyqtarët mbikëqyrës të degëve shfaqën shqetësimin lidhur me procedurat e tej zgjatura të riemërimit të gjyqtarëve, në disa raste deri në 2 vite, që shkakton pengesa në punën e tyre.

Sipas tyre nuk ekziston vullnet i mjaftueshëm që të paktën në rastet e pensionimit, kur dihet moshë e gjyqtarëve të shpallet konkursi më herët për zëvendësimin e tyre.

- Lëndët me mungesë të të dhënave personale për palën e akuzuar

Problem prezent në të gjitha gjykatat dhe degët në Kosovë janë lëndët me mungesë të të dhënave për palët e akuzuara. Përveç për lëndët vjedhje e pyllit mungesa e të dhënave përfshin thuaja se të gjitha kategoritë e lëndëve penale. P.sh. ka raste kur në lëndë figuron vetëm emri dhe mbiemri i personit si dhe një përshkrim i përafërt i moshës, pa emër të babait, datë të lindjes, numër personal po numër telefoni¹⁰.

Edhe pse flitet për një kujdes më të shtuar vitet e fundit¹¹ nga prokuroritë lidhur me paraqitjen e lëndëve si dhe kujdes më të shtuar edhe nga gjykatat për kthimin e lëndëve në prokurori për plotësim, prapë se prapë ky mbetet problem tejet serioz.

Gjykatat dhe degët konsiderojnë se procedura e kthimit të lëndëve në prokurori përveç që kërkon kohë, jo gjithmonë rezulton suksesshëm pasi që prokuroria deklaron se në rastin e tillë ekziston dyshim i bazuar se është kryer veprë penale dhe gjykata obligohet ta trajtojë atë lëndë.

Mungesa e të dhënave konsiderohet si problem që pamundëson ekzekutimin e këtyre lëndëve dhe mund të konsiderohet edhe si një faktor që çon lëndët për vjedhje pylli drejt parashkrimit.

b) Problemet që barteshin nga jashtë, institucionet tjera vartëse të ekzekutimit apo të rëndësishme tjetër

Në tjetër element i rëndësishëm i hasur gjatë hulumtimit ishin edhe pengesat që vinin nga institucionet tjera me rol kyç në trajtimin e lëndëve për vjedhje pylli.

¹⁰ Numrat e telefonit për faktin që tanimë janë të regjistruar konsiderohen si e dhënë me rëndësi nga ana e gjykatave. Regjistrimi i numrave telefonik u bë pas vendimit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit (ART) i cili hyri në fuqi nga data 01 tetor 2010.

<http://www.arkep-rks.org/repository/docs/Rregullore%20per%20regjistrimin%20perdoruesve%20telefonise%20mobile.pdf>

¹¹Kjo periudhë nënkupton fillimin e vitit 2013 e tutje, pra periudhën prej hyrjes në fuqi të reformave të sistemit gjyqësor.



- Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave nga Policia e Kosovës

Një numër i madh i lëndëve edhe pas shpalljes së aktgjykimit nga gjykatat nuk arrijnë të ekzekutohen nga ana e Policisë së Kosovës (PK). Nga informatat në gjykata deklarohen se përkundër bashkëpunimit të mirë me Policinë e Kosovës në parim gjatë takimeve të rregullta në mes tyre hasin në ankesa se kanë mungesë të stafit dhe të pajisjeve. Mungesa e të dhënave mbi të akuzuarit paraqet problem edhe për policinë pasi që kjo e pamundëson gjetjen e palëve si për sjellje në seanca gjyqësore po ashtu edhe për arrestim në rastet kur është shpallur gjykimi.

- Agjencioni Pyjor i Kosovës – rojet e pyllit

Gjykatat dhe degët në përgjithësi kishin ankesa sa i përket fletëparaqitjeve dhe të dhënave që plotësohen nga rojet e pyllit, pasi që në to mungonin të dhënat mbi personat e akuzuar për vjedhje pylli. Problem ky që pastaj përcillte lëndët deri në fund dhe pamundësonte trajtimin e lëndëve nga gjykatat. Përveç dorëzimit të fletëparaqitjeve me mungesë të të dhënave rojet e pyllit shpesh nuk arrijnë të bëjnë as identifikimin e të akuzuarve në seanca gjyqësore.

Sipas ligjit për pyjet e Kosovës Nr. 2003/3, Neni 29, pika 29.3 për kryerjen me sukses të detyrës, rojet e pyjeve do të bashkëpunojnë me organet e rendit publik dhe inspektionin e pylltarisë, por në praktikë ky bashkëpunim nuk po aplikohet sa është nevoja.

Problemet me rojet e pyllit nuk mbarojnë këtu. Gjyqtarët shpallorin edhe ankesat e vazhdueshme që vijnë nga palët e akuzuara në seancat gjyqësore. Sipas tyre, të akuzuarit pretendojnë se u është bërë padrejtësi nga rojet e pyllit për masën drunore të ngarkuar në akuzë, duke aluduar në përpjekje të rojtarëve të arsyetojnë prerjet masive në pyjet që ata monitorojnë duke ngarkuar ata padrejtësisht. Po ashtu dyshime ngritën edhe mbi vërtetësinë e fletëparaqitjeve që rojet e pyllit dërgojnë në prokurori, duke akuzuar kështu prokurorinë që përkundër parregullsive asnjëherë nuk ka filluar hetimet për rojet e pyllit.

4. PARASHKRIMI I LËNDËVE PENALE PËR VJEDHJE PYLLI

Parashkrimi i lëndës penale lind kur kryesi i veprës penale nuk mund të zbulohet, ose mund të ndodhë që kryesi të dihet por organet e ndjekjes penale nuk mund ta gjejnë atë. Po ashtu, mund të ndodhë që kryesi i veprës penale të dënohet, por pas shqiptimit të dënimit paraqiten pengesa reale apo juridike të cilat e bëjnë të pamundshëm ekzekutimin e dënimit.¹²

“Parashkrimi apo vjetërsimi është institut juridik i cili shpie në shuarjen e sanksioneve penale për shkak të kalimit të kohës së caktuar me ligj. Kur paraqitet parashkrimi, shteti humb të drejtën e zbatimit të sanksioneve penale ndaj kryesit të veprës penale”¹³.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, njeh dy lloje të parashkrimit: **1. parashkrimin e ndjekjes penale dhe 2. parashkrimin e ekzekutimit të dënimit.** Të dy llojet e parashkrimit mund të ndahen pastaj në parashkrim relativ dhe absolut. Parashkrimi relativ¹⁴, nënkupton kalimin e afatit të paraparë me ligj prej kohës së kryerjes së veprës penale deri në momentin kur nuk mund të fillohet ndjekja ose nuk mund të fillojë ekzekutimi tek parashkrimi i ekzekutimeve të dënimeve. Ndërsa parashkrimi absolut¹⁵, nënkupton kalimin e dyfishit të kohës së paraparë me ligj, prej momentit të kryerjes së veprës penale deri në kohën kur nuk mund të fillohet ndjekja, ose ekzekutimi i dënimit të shqiptuar tek rasti i parashkrimit të ekzekutimeve të dënimeve. Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale.

4.1 Pasqyra e të dhënave të parashkrimit të lëndëve për vjedhje pylli për vitin 2013 dhe vitin 2014

Në nenin 358, vjedhja e pyllit, Kodi Penal i Republikës së Kosovës për kryesin e veprës penale parasheh dënim me gjobë dhe me burgim nga 3 muaj deri në 3 vjet¹⁶. Kjo kohë gjatësi e masës ndëshkimore përcakton edhe kohën e parashkrimit të lëndëve për vjedhje të pyllit.

Sipas nenit 106 të KPRK-së, ndjekja penale nuk mund të vazhdojë/fillojë pasi të kenë kaluar

- 1) Tridhjetë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm;
- 2) Njëzet vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me dhjetë vjet burgim;
- 3) Dhjetë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me pesë vjet burgim;
- 4) Pesë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me tri vjet burgim;
- 5) Tri vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim dhe;

¹² Salihu, Ismet; “**E Drejta Penale**”; Universiteti Fama, Prishtinë, 2008, faqe558..

¹³Po aty, faqe558.

¹⁴Po aty, faqe 563.

¹⁵Ndalja dhe ndërprerja e përshkrimit mund të shpijnë praktikisht në një situatë që të mos shkaktohet parashkrimi. Sidomos me ndërprerjen gjithherë mund të ndërmarrin veprime me të cilat do të bënin të pamundshme kuptimin dhe qëllimin e parashkrimit. Për t’iu shmangur kësaj mundësie, e drejta penale bashkëkohore parasheh parashkrimin absolut. Po aty faqe 563.

¹⁶ Kodi Penali Republikës së Kosovës, Neni 358, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>



6) Dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me një vit apo dënim me gjobë.

Në raportin monitorues të realizuar nga Organizata Çohu! për parashkrimin e lëndëve nga viti 2001 deri në vitin 2014 rezulton që vepra penale që është parashkruar më së shumti është vjedhja e pyllit neni 358/285 me gjithsej 1783 lëndë të parashkuara.

Nga 6610 lëndë për vjedhje pylli sa ishin në punë në vitin 2014, në të gjitha gjykatat themelore dhe degët në mbarë Kosovën, janë parashkruar 604 lëndë, apo 9.14 % e totalit të lëndëve në punë. Nga ky numër i madh i lëndëve të parashkuara, 558 lëndë apo 92.4 % janë lëndë që i takojnë parashkrimit absolut, ndërsa 46 lëndë apo 7.6 % e tyre janë lëndë që u parashkruan nën kategorinë relative të parashkrimit.

Gjykatat dhe Degët që prijnë me numrin më të madh të lëndëve të parashkuara për vitin 2014 janë: Podujeva 276 lëndë, Gjilani 48, Vitia 25, Mitrovica 37, Istogu 38, Ferizaji 93 dhe Kaçaniku 22, të cilat po ashtu prijnë edhe me numrin më të madh të lëndëve në punë.

Për vitin 2013 numri i lëndëve të parashkuara ishte dukshëm më i lartë me gjithsej 999 lëndë të parashkuara. Nga ky total i lëndëve të parashkuara 944 lëndë i takojnë parashkrimit absolut dhe 55 lëndë u parashkruan nën kategorinë relative.

Krahasimi i të dhënave nga viti 2013 dhe 2014 tregon një rënie të parashkrimit për lëndët vjedhje e pyllit për 39,54%, që mund të konsiderohet si indikatorë që shtimi i numrit të gjyqtarëve ka dhënë rezultat.

Mirëpo, në anën tjetër trendi i përgjithshëm i parashkrimit dhe shifrat tejet të larta nuk japin shpresë për ndonjë ndryshim radikal sa i përket parashkrimit të lëndëve për vjedhje pylli. Në përgjithësi dominon parashkrimi absolut mirëpo parashkrimi relativ mbetet ende tejet i lartë në shifra. Ky është indikator mjaft problematik pasi që parashkrimi relativ kryesisht ndodh për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve nga ana e gjyqtarëve.

Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) konfirmon se ka raste që janë hetuar për sjellje të mundshme të pahijshme të kryer nga gjyqtarët për shkak se të njëjtit kanë treguar neglizhencë në kryerjen apo vendosjen e rasteve duke lejuar parashkrimin. Në vitin 2015, kemi tre raste që janë në fazën e grumbullimit të informacioneve për të vlerësuar nëse ka elemente të sjellje së pahijshme të kryer nga gjyqtarët. Në vitet e kaluara (viti 2013 dhe 2014) ka pasur raste që janë hetuar dhe përfunduar për rastet e ambientit. ZPD nuk i regjistron rastet si raste të ambientit në bazën e të dhënave prandaj në këtë fazë të monitorimit ishte e pamundshme sigurimi i të dhënave specifike për rastet që lidhen me ambientin apo vjedhjen e pyllit.

Tabela 1 . Parashkrimi i lëndëve, Neni 358/285 Vjedhja e pyllit

| PARASHKRIMI I LËNDËVE Neni 358/285 Vjedhja e pyllit | Viti 2014 | | | Viti 2013 | | |
|--|----------------------|------------|-----------|-------------------------------|------------|-----------|
| | Lëndë të Parashkuara | Absolut | Relativ | Gjithsej lëndë të Parashkuara | Absolut | Relativ |
| Gjykata Themelore Prishtinë | 8 | 5 | 3 | 33 | 32 | 1 |
| Dega Podujevë | 276 | 243 | 33 | 362 | 360 | 2 |
| Dega Lipjan | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dega Gillogoc | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjykata Themelore Gjilan | 48 | 43 | 5 | 89 | 87 | 2 |
| Dega Kamenicë | 7 | 6 | 1 | 25 | 17 | 8 |
| Dega Viti | 25 | 25 | 0 | 117 | 116 | 1 |
| Dega Novobërdë | 4 | 4 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjykata Themelore Prizren | 10 | 10 | 0 | 22 | 18 | 4 |
| Dega Dragash | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dega Suharekë | 11 | 11 | 0 | 4 | 4 | 0 |
| Gjykata Themelore Mitrovicë | 37 | 37 | 0 | 4 | 3 | 1 |
| Vushtrri | 1 | 1 | 0 | 2 | 2 | 0 |
| Skenderaj | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 0 |
| Gjykata Themelore Gjakovë | 3 | 3 | 0 | 2 | 2 | 0 |
| Dega Malishevë | 5 | 5 | 0 | 12 | 3 | 9 |
| Dega Rahovec | 1 | 0 | 1 | 2 | 2 | 0 |
| Gjykata Themelore Pejë | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| Dega Istog | 38 | 38 | 0 | 211 | 184 | 27 |
| Dega Klinë | 0 | 0 | 0 | 11 | 11 | 0 |
| Dega Deçan | 10 | 7 | 3 | 1 | 1 | 0 |
| Gjykata Themelore Ferizaj | 93 | 93 | 0 | 51 | 51 | 0 |
| Kaçanik | 22 | 22 | 0 | 46 | 46 | 0 |
| Shtërpcë | 4 | 4 | 0 | 3 | 3 | 0 |
| Total | 604 | 558 | 46 | 999 | 944 | 55 |

Tabela 2: përqindja e parashkrimit në raport me numrin e lëndëve në punë si dhe në raport me lëndët e zgjidhura në fund vitit..



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET –ÇOHU


| Neni 358/285 Vjedhja e pyllit | Viti 2014 | | | | | Viti 2013 | | | | |
|--|---|---------------------|------------------------------|--|---|---|---------------------|------------------------------|--|---|
| | Lëndë të zgjidhura në fund të vitit | Lëndë në Punë | Lëndë të Parashkr uara | Përqindja e parashkrimit në raport me numrin total të lëndëve në punë | Përqindja e parashkrim it në raport me lëndët e zgjidhura në fund vit. | Lëndë të zgjidhura në fund të vitit | Lëndë në Punë | Lëndë të Parashkr uara | Përqindja e parashkrimit në raport me numrin total të lëndëve në punë | Përqindja e parashkrim it në raport me lëndët e zgjidhura në fund vit. |
| Gjykata Themelore Prishtinë | 40 | 287 | 8 | 2.78% | 20.00% | 55 | 236 | 33 | 13,98% | 60,00% |
| Dega Podujevë | 773 | 2107 | 276 | 13,00% | 35.7% | 656 | 1970 | 362 | 18,37% | 55,18% |
| Dega Lipjan | 22 | 29 | 0 | 0 | 0 | 38 | 55 | 0 | 0 | 0 |
| Dega Glllogoc | 22 | 38 | 0 | 0 | 0 | 25 | 46 | 0 | 0 | 0 |
| Gjykata Themelore Gjilan | 166 | 417 | 48 | 11.5 % | 28.91% | 146 | 455 | 89 | 19,56% | 60,96% |
| Dega Kamenicë | 58 | 208 | 7 | 3.36 % | 12.00% | 67 | 196 | 25 | 12,75% | 37,31% |
| Dega Viti | 364 | 762 | 25 | 3.44 % | 6.87% | 283 | 785 | 117 | 14,90% | 41,34% |
| Dega Novobërdë | 54 | 70 | 4 | 5.71 % | 7.40% | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| Gjykata Themelore Prizren | 32 | 69 | 10 | 14.4 % | 31.25% | 54 | 86 | 22 | 25,58% | 40,74% |



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET –ÇOHU

| | | | | | | | | | | |
|-----------------------------|-------------|-------------|------------|--------------|---------------|-------------|-------------|------------|---------------|---------------|
| Dega Dragash | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Dega Suharekë | 28 | 111 | 11 | 9.90 % | 39.28% | 9 | 46 | 4 | 8,69% | 44,44% |
| Gjykata Themelore Mitrovicë | 61 | 141 | 37 | 26.24 % | 60.65% | 69 | 176 | 4 | 2,27% | 5,80% |
| Vushtri | 16 | 22 | 1 | 4.54 % | 6.25% | 13 | 13 | 2 | 15,38% | 15,38% |
| Skenderaj | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 19 | 24 | 2 | 8,30% | 10,52% |
| Gjykata Themelore Gjakovë | 11 | 23 | 3 | 13.04 % | 27.27% | 11 | 24 | 2 | 8,30% | 18,18% |
| Dega Malishevë | 82 | 165 | 5 | 3.03 % | 6.09% | 81 | 192 | 12 | 6,25% | 14,81% |
| Dega Rahovec | 6 | 15 | 1 | 6.66 % | 16.67% | 8 | 13 | 2 | 15,38% | 25,00% |
| Gjykata Themelore Pejë | 42 | 90 | 1 | 1.11 % | 0.02% | 32 | 56 | 0 | 0 | 0 |
| Dega Istog | 191 | 544 | 38 | 6.98 % | 19.89% | 328 | 754 | 211 | 27,98% | 64,33% |
| Dega Klinë | 46 | 233 | 0 | 0 | 0 | 170 | 334 | 11 | 3,29% | 6,47% |
| Dega Deçan | 46 | 55 | 10 | 18.18 % | 21.74% | 34 | 57 | 1 | 1,75% | 2,94% |
| Gjykata Themelore Ferizaj | 320 | 821 | 93 | 11.32 % | 29.06% | 223 | 784 | 51 | 6,50% | 22,87% |
| Kaçanik | 97 | 260 | 22 | 8.46 % | 22.68% | 138 | 291 | 46 | 15,81% | 33,33% |
| Shtërpcë | 80 | 143 | 4 | 2,80% | 5,00% | 9 | 46 | 3 | 6,52% | 33,33% |
| Total | 2559 | 6610 | 604 | 9.14% | 23.60% | 2469 | 6641 | 999 | 15,94% | 40,46% |

Grafi 4: Përqindja e lëndëve të parashkuara në raport me lëndët në punë për vitin 2013 dhe 2014





Një trend tjetër që shfaqet në bazë të të dhënave janë edhe Gjykatat dhe Degët me numër dukshëm të lartë të parashkrimit në raport me lëndët në punë për veprën penale vjedhje e pyllit. Për vitin 2014 prinë Mitrovica me 26.24 % të lëndëve të parashkruara për këtë kategori, pastaj vjen Deçani me 18.8 % të lëndëve të parashkruara, Prizreni 14.40%, Gjakova 13.04%, Podujeva 13%, Gjilani 11.50%, dhe Ferizaj me 11.32% të lëndëve të parashkruara.

Në vitin 2013 gjykatat që prijnë me përqindje të lëndëve të parashkruara në raport me lëndët në punë janë: Istogu me 27%, Prizreni me 25,58%, Gjilani 19.56%, Podujeva me 18.37% dhe.

Karakteristikë e këtyre shifrave është edhe parashkrimi tejet i lartë si në rastin e Gjykatës Themelore të Prizrenit në të dy vitet edhe pse numri i lëndëve në punë në këtë gjykatë nuk është shumë i lartë krahasuar me gjykatat dhe degët tjera.

Shifrat e lartpërmendura po ashtu japin një indikator shumë të rëndësishëm i cili lidhet me aftësinë dhe kapacitetin e gjykatave për trajtimin e këtyre lëndëve.


Duke marrë parasysh që në shifrën e totalit të lëndëve të zgjidhura në bazë vjetore për vjedhje pylli hyjnë edhe lëndët e parashkruara, të dhënat e mëposhtme tregojnë që një numër i konsiderueshëm i lëndëve brenda vitit zgjidhen duke u parashkruar.

Gjykata Themelore e Mitrovicës vetëm për vitin 2014 nga 61 lëndë të zgjidhura në fund vit, 60,65% të tyre i ka parashkruar. Pas Mitrovicës pason Suhareka me 39,28%, pastaj Podujeva me 35.7%, Prizreni me 31,25%, Ferizaj me 29,06%, Gjilani 28,91%, Gjakova 27,27% etj.

Këto të dhëna tregojnë se për vitin 2014, nga totali i lëndëve të zgjidhura 23.60% e lëndëve janë lëndë që përfunduan me parashkrim.

Në vitin 2013 shifrat janë edhe më të larta ku nga 2469 lëndë të zgjidhura në fund të vitit 40,46%, gati gjysma e tyre, janë lëndë që u parashkruan.

Grafi 4: Përqindja e lëndëve të parashkruara në raport me lëndët e zgjidhura në fund vit për vitin 2013 dhe 2014



4.2 Indikatorët me ndikim në parashkrimin e lëndëve për vjedhje pylli

Këtë numër tejet të lartë të parashkrimit të lëndëve për vjedhje pylli gjykatat themelore dhe degët e shohin përveç si pasqyrim i degradimit dhe vjedhjes masive që iu bëhen pyjeve në Kosovë edhe si arenë ku gërshetohen një sërë problemesh. Më poshtë kemi identifikuar një varg problemesh që ndikojnë drejtpërsëdrejti në parashkrimin e lëndëve të kategorisë vjedhje e pyllit.

- Numri i gjyqtarëve në raport me lëndët

Disa nga gjykatat dhe degët ende kanë numër tejet të lartë të lëndëve të grumbulluara në raport me numrin e gjyqtarëve. Pra thjesht nuk kanë infrastrukturë të mjaftueshme për trajtimin e lëndëve, përfshirë këtu edhe lëndët për vjedhje pylli.

- Numër i madh i lëndëve por pa prioritet

Përkundët gjendjes së mjerueshme të pyjeve në Kosovë nga prerjet e vazhdueshme ilegale dhe numrit tejet të lartë të lëndëve për vjedhje pylli këto lëndë nuk kanë kurrfarë prioriteti në raport me lëndët tjera. Në parim ?

Kjo paraqet edhe një indikator që me numër të lartë të lëndëve sa kanë të grumbulluara gjykatat dhe pa ndonjë prioritet, edhe në të ardhmen parashkrimi i këtyre lëndëve do të jetë prezent.

- Lëndët e pashqyrtuara ndër vite

Një numër i këtyre lëndëve janë të trashëguara ndër vite dhe në momentin e shqyrtimit disa nga to tanimë kanë arritur në fazë të parashkrimit dhe nuk ka mundësi të procedohet më tej me to.

- Zvogëlimi i masës ndëshkimore me Kodin e Ri Penal të Republikës së Kosovës

Me Kodin e vjetër Penal, apo Kodi i Përkohshëm Penal, ndëshkimi për vepër penale vjedhje e pyllit ishte deri në 5 vite¹⁷, ndërsa kjo masë është zvogëluar me Kodin e ri Penal të Republikës së Kosovës në 3 vite. Kjo po ashtu ka ndikuar në parashkrimin e një numri të lëndëve për vjedhje pylli pasi që në parim lënda shqyrtohet me ligjin më të favorshëm për të akuzuarin. Sipas Nenit 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

¹⁷ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës

http://gazetajnkk.com/repository/docs/RA2003_25_CCintranet_295748.pdf



- Mungesa e të dhënave elementare për të akuzuarit

Problem tjetër i shprehur në masë të madhe është edhe mungesa e të dhënave në lëndët e dërguara në gjykata për vjedhje pylli. Sipas gjyqtarëve ka raste kur në dokumente figuron vetëm emri dhe mbiemri dhe ndonjë përshkrim i përafërt si p.sh. me moshë afër të 20-tave. Kjo mungesë e të dhënave e bën të pamundur identifikimin e personave si nga gjykata po ashtu edhe nga policia dhe si pasojë parashkrimi në këto raste është i paevitueshëm. Prokuroria vazhdon dërgimin e lëndëve në gjykatë me mungesë të të dhënave, edhe pse së fundmi me shtimin e numrit të gjyqtarëve për disa gjykata dhe degë është më e thjeshtë që lëndët të kthehen prapa në prokurori për plotësim. Kjo procedurë sipas gjykatave jo gjithmonë jep efektin e duhur pasi që shkakton vonesa si dhe në disa raste përgjigjet nga prokuroria janë thjeshtë se për lëndën ka dyshim të mjaftueshëm për kryerje të veprës penale dhe kjo automatikisht detyron gjykatën të procedojë këto lëndë.

- Autoritetet pyjore – rojet e pyllit

Autoritetet e pyllit, përkatësisht rojet e pyllit paraqesin fletëparaqitje me mungesë elementare të të dhënave. Ata shpesh nuk arrijnë të bëjnë identifikimin e palës as në seanca gjyqësore edhe pse roli i tyre është kyç pasi që për lëndët vjedhje pylli në shumicën e rasteve janë të vetmit dëshmitarë. Mungesa e të dhënave dhe vështirësitë për identifikimin e të akuzuarve paraqitet si problem në të gjitha gjykatat.

Sipas informatave në gjykata thuhet se në seancat gjyqësore paraqiten mjaft akuza të drejtuara kundrejt rojeve të pyllit për shkelje dhe padrejtësi nga ana e tyre. Të akuzuarit shpesh pretendojnë se janë dënuar padrejtësisht dhe se rojet e pyllit me këto veprime arsyetojnë prerjet tjera masive, ilegale që iu bëhen pyjeve.

- Mosekzekutimi i aktgjykimeve

Policia nuk arrin të ekzekutojë (vendimet për?) personat kryes të veprës penale vjedhje e pyllit. Gjykatat raportojnë për bashkëpunim të mirë me policinë mirëpo sipas tyre mungesa e të dhënave paraqet problem edhe për ta. Në disa gjykata pamundësinë e arrestimit të personave për vjedhje pylli e arsyetojnë edhe me mungesë të stafit të policisë por edhe mjeteve të punës si automjetet.

5. Masat ndëshkimore për vjedhje pylli

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh masën ndëshkimore për veprën penale vjedhje e pyllit në nenin 358 pikën një dhe dy. Sipas këtij neni “Nëse vepra penale ...kryhet me qëllim që drunjtë e prerë të shiten; nëse sasia e druve të prerë është mbi pesë (5) metra kub; ose nëse vepra penale është kryer në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”

5.1 Pasqyra e të dhënave mbi lëndët e zgjidhura me aktgjykim

Në vitin 2014, në gjykatat themelore dhe degët në Kosovë, nga 2559 lëndë të zgjidhura me gjobë janë dënuar 1056 raste, me burgim 199 raste, me kusht janë dënuar 291 raste dhe dënimet tjera janë 60 raste.

Këto shifra na ofrojnë trend mjaft interesant të dënimeve. Në përgjithësi prijnë dënimet me gjobë në krahasim me dënimet me burgim apo ato me kusht. Në Gjykatën Themelore të Podujevës kemi 401 raste të dënimit me gjobë dhe asnjë rast të dënimit me burgim, Dega në Viti 156 raste me gjobë dhe vetëm tri raste me burgim, në Gjykatën Themelore Ferizaj 108 dënime me gjobë dhe 53 raste të dënimit me burgim. Në disa gjykata dhe degë dënimet me burgim dhe ato me gjobë nuk përbëjnë dallim kaq të thellë sa në rastet e lartpërmendura.

Një trend tjetër që paraqesin këto shifra janë edhe gjykatat apo degët në të cilat prijnë dënimet me burgim krahasuar me dënimet me gjobë. Në Degën e Novobërdës kemi 22 raste të dënimit me burgim dhe asnjë rast të dënimit me gjobë, Dega Kaçanik për këtë vit ka 36 dënime me burgim dhe 27 raste të dënimit me gjobë dhe Dega Deçan ku janë 14 raste të dënimit me burgim dhe vetëm 3 raste të dënimit me gjobë.

Në përgjithësi nuk posedojmë informata rreth asaj se sa janë vlerat minimale dhe maksimale të gjobave të shqiptuara për vjedhje pylli po edhe të dënimeve me burgim, mirëpo sipas disa informatave joformale nga gjykatat dënimet me gjobë sillen nga 60 euro deri në 1500 euro sa konsiderohet gjoba maksimale.

Në përgjithësi gjyqtarët ishin të mendimit se masat ndëshkimore për vjedhje pylli ishin mjaft të buta. Gjithashtu duhet përmendur se me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës masa ndëshkimore është zvogëluar nga 5 vite burgim, sa ishte në të vjetrin, në 3 muaj deri në 3 vite.

Në vitin 2013 Shefi i Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, Ahmet Zjenullahu, para Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor u shpreh se “Shqyrtimi i lëndëve nga sektori i pylltarisë ende mbetet brengë e madhe e po ashtu edhe dënimet. Nganjëherë fitohet përshtypja se këto masa më tepër janë stimuluese sesa që janë ndëshkuesë”.

Tabela: Lëndët për vjedhje pylli të zgjidhura me aktgjykim gjykues dhe llojet e dënimeve për vitin 2014




ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET – ÇOHU

| Neni 358/285 Vjedhja e pyllit Viti 2014 | Viti 2014 | | | | Viti 2013 | | | |
|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|-----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|-----------------|
| | Dënim me burgim | Dënim me gjobë | Dëni m me kusht | Dënime tjera | Dënim me burgim | Dënim me gjobë | Dëni m me kusht | Dënime tjera |
| Gjykata Themelor e dhe Degët | | | | | | | | |
| Gjykata Themelor e Prishtinë | 5 | 9 | 11 | 0 | 1 | 6 | 8 | 0 |
| Dega Podujevë | 0 | 401 | 2 | 0 | 0 | 267 | 0 | 0 |
| Dega Lipjan | 0 | 15 | 4 | 0 | 0 | 36 | 1 | 0 |
| Dega Glllogoc | 0 | 10 | 5 | 1 | 0 | 13 | 11 | 1 |
| Gjykata Themelor e Gjilan | 26 | 52 | 25 | 1 | 2 | 22 | 24 | 0 |
| Dega Kamenicë | 2 | 36 | 4 | 2 | 0 | 14 | 20 | 0 |
| Dega Viti | 3 | 156 | 59 | 2 | 7 | 73 | 36 | 0 |
| Dega Novobërd ë | 22 | 0 | 21 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| Gjykata Themelor e Prizren | 0 | 13 | 6 | 1 | 1 | 18 | 12 | 0 |
| Dega Dragash | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | | |
| Dega Suharekë | 0 | 5 | 10 | 0 | 0 | 5 | 0 | 0 |
| Gjykata Themelor e Mitrovicë | 1 | 12 | 5 | 0 | 1 | 47 | 6 | 0 |
| Vushtrri | 0 | 6 | 8 | 0 | 0 | 3 | 2 | 0 |
| Skenderaj | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 12 | 1 | 0 |
| Gjykata Themelor e Gjakovë | 0 | 4 | 2 | 0 | 0 | 4 | 3 | 0 |



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET – ÇOHU

| | | | | | | | | |
|----------------------------|-----|------|-----|----|----|------|-----|---|
| Dega Malishevë | 0 | 52 | 18 | 0 | 7 | 52 | 7 | 0 |
| Dega Rahovec | 0 | 1 | 1 | 2 | 0 | 4 | 1 | 0 |
| Gjykata Themelor e Pejë | 0 | 6 | 18 | 2 | 1 | 10 | 12 | 1 |
| Dega Istog | 29 | 60 | 36 | 6 | 0 | 82 | 19 | 0 |
| Dega Klinë | 0 | 33 | 10 | 1 | 1 | 150 | 1 | 3 |
| Dega Deçan | 14 | 3 | 16 | 1 | 1 | 11 | 18 | 1 |
| Gjykata Themelor e Ferizaj | 53 | 108 | 17 | 37 | 0 | 146 | 18 | 1 |
| Kaçanik | 36 | 27 | 11 | 0 | 8 | 68 | 10 | 0 |
| Shtërpçë | 8 | 47 | 2 | 10 | 0 | 24 | 8 | 0 |
| Total | 199 | 1056 | 291 | 66 | 30 | 1002 | 210 | 7 |





6. Përfundimi

Ajo çfarë ky raport pasqyron është se trajtimi i lëndëve penale për vjedhje pylli në gjykatat themelore dhe degët e Kosovës vazhdon të mbetet një çështje tejet problematike. Filluar nga numri i lartë i lëndëve në gjykata, numri i lartë i lëndëve të paraqitura në bazë vjetore, lëndët për vjedhje pylli janë ndër lëndët me parashkrimin më të lartë në nivel kombëtar. Numri i lëndëve të zgjidhura për veprën penale vjedhje e pyllit përaftron numrin e lëndëve që hyjnë brenda vitit në punë mirëpo, kur kalkulohet numri i lëndëve që bartet në vitet pasuese së bashku me numrin e lëndëve që hyjnë në punë në baza vjetore, shifra e përgjithshme e numrit të lëndëve në punë mbetet thuajse e njëjtë.

Parashkrimi i veprës penale vjedhje e pyllit është jashtë çfarëdo standardi e lartë, përfshirë këtu parashkrimin absolut dhe atë relativ. Edhe pse në përgjithësi parashkrimi i lëndëve penale është i papranueshëm, parashkrimi relativ paraqet shqetësim më të lartë, sidomos pasi kjo mbetet përgjegjësi e gjyqtarëve dhe vjen si pasojë e mos ndërmarrjes së asnjë veprimi për lëndët në fjalë. Mjafton një veprim i vetëm nga ana e gjyqtarëve që për këto lëndë penale shteti të mos humb të drejtën e ndjekjes dhe ekzekutimit penal. Shumë lëndë, si rezultat i grumbullimit të tyre ndër vite, në momentin e shqyrtimit veçse kanë arritur në fazën e parashkrimit.

Krahasimi i të dhënave nga viti 2013 dhe 2014 tregon një rënie të parashkrimit për lëndët vjedhje e pyllit për 39,54%, që mund të konsiderohet si indikatorë që shtimi i numrit të gjyqtarëve ka dhënë rezultat në trajtimin e lëndëve. Por, njëkohësisht kjo tregon edhe që lëndët e grumbulluara ndër vite po shqyrtohen me prioritet dhe me zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara do të zvogëlohet e parashkrimi për këto lëndë, pasi që një numër i tyre në momentin e shqyrtimit veçse kanë arritur në fazën e parashkrimit.

Mirëpo përgjithësisht numri i lëndëve të parashkruara ende është tejet i lartë dhe shqetësues.

Përkundër reformës në sistemin gjyqësor gjykatat themelore dhe degët e tyre përkatëse vazhdojnë të kenë pengesa që burojnë nga vetë organizimi i sistemit gjyqësor. Shtimi i numrit të gjyqtarëve për disa gjykata themelore dhe degë mbetet ende një ndër sfidat kryesore. Përveç numrit të pamjaftueshëm në disa degë dhe gjykata edhe procedura e zëvendësimit të gjyqtarëve shfaqet si problem pasi që procedurat e emërimit të gjyqtarëve të ri zgjasin shumë dhe pamundësojnë mbajtjen e një ritmi të punës. Mungesa e të dhënave elementare në lëndët penale përveç që paraqet problem madhorë dhe pamundëson trajtimin e këtyre lëndëve, vë në pah edhe lëshimet e institucioneve me rastin e lëndëve të paraqitura si nga ana e prokurorisë por edhe e gjykatave. Për vite gjykatat u ngarkuan me lëndë, edhe ashtu të shumta në numër dhe me pamundësi trajtimi, të cilat në mungesë të të dhënave për personat e akuzuar janë lëndë që domosdo përfundojnë në parashkrim. Këto



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET – ÇOHU

lëndë me mungese të të dhënave shpesh dyshohet se janë sjellë qëllimisht vetëm si mbulesë nga ana e rojeve të pyllit për vjedhjet që kanë ndodhur.

Një element tjetër që ky monitorim vë në pah është edhe masa ndëshkimore e cila në përgjithësi konsiderohet e ulët. Për më tepër kur masa ndëshkimore dënim me burg aplikohet shumë pak duke krijuar tendencë që shkelësit të dënohen me gjoba ose me kusht. Mos kërkesa e prokurorive për aplikimin e masës me burgim dhe mos shqiptimi i dënimeve me burgim nga gjykatat ka tendencë që kanë rritur numrin e rasteve të prerjes së pyllit, e me rritjen e rasteve normale që rritet edhe numri i parashkrimit për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve dhe lëndëve edhe ashtu të larta në numër.



Falenderim i veçantë për ata që me kontributin e tyre bënë të mundur raportin:

- Hamdi Ibrahim – kryetar i Gjykatës Themelore të Prishtinës
- Gazmend Bahtiri – gjyqtar mbikëqyrës në Degën Podujevë
- Elmaze Syja – kryetare e Gjykatës Themelore të Pejës
- Safete Tolaj – gjyqtare mbikëqyrëse Dega Deçan
- Jashar Gashi – gjyqtar mbikëqyrës Dega Klinë
- Zef Prendrecaj – drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor
- Fejzullah Hasani – kryetar i Gjykatës Supreme



ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTI-KORRUPSION DHE DINJITET – ÇOHU

Përgatitur nga:
Florie Xhemajli

Lekturoi:
Besa Kalaja

Kontribuuesit:
Arton Demhasaj
Alban Bokshi
Qëndrim Bunjaku

Publikuar nga:
Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
Rruga: Rrustem Statovci; Nr. 17, Prishtinë, Kosovë
Tel/ +381(0)38 248 506
www.cohu.org
Janar, 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky projekt është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).